



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:265350

Datë: 21.02.2024

Numri i dokumentit: 05353699

AA.nr.517/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses S.G nga Komuna e Klinës, me përfaqësuesin ligjor – bashkëshortin Sh.G, të cilën me autorizim e përfaqëson Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve të Republikës së Kosovës, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.833/2019 të datës 30.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.833/2019 i datës 30.05.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.833/2019 të datës 30.05.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar kërkesën e paditëses, S.G nga komuna e Klinës, për nxjerrën e aktit të cilin nuk e ka nxjerr organi administrativ, si e bazuar. Në pikën II të dispozitivit e ka anuluar vendimin e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës në Prishtinë, të datës 17.12.2018, me numër të ankesës 5018 dhe vendimin e datës 07.09.2018, ndërsa paditëses i njihet e drejta në kompensimin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik në kategorinë e grupit të parë, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh dhe atë nga data e nxjerrjes së vendimit datë 30.05.2023 e deri me datën 30.05.2028. Në pikën III të dispozitivit e ka detyruar të paditurën, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale, që paditëses në mënyrë retroaktive t'ia kompensoj pagesat në emër të kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në kategorinë e grupit të parë, që nga dita e kërkesës/ aplikimit të këtij pensioni datë 16.04.2018, deri me datën 17.03.2023, dhe atë në shumën e përgjithshme të pensioneve mujore 22.500.00 euro (njëzetedymijë e pesëqind euro) dhe kamatën prej

8% sipas LMD-së në shumën prej 5.254.52(pesëmijë e dyqind e pesëdhjetekatër euro e pesëdhjetë e dy cent) e në total prej 27.754.52 (njëzeteshtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër euro e pesëdhjetë e dy cent), nga data e kërkesës/ aplikimit së këtij pensioni, deri në pagesën definitive, krejt këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nën pasojat e përmbartimit me detyrim. Në pikën IV të dispozitivit e ka udhëzuar paditësen që pas 5(pesë) viteve nga momenti i njohjes së kësaj të drejte, të paraqesë kërkesë për rivlerësim mjekësorë tek e paditura, për të vazhduar njohjen e kësaj të drejte. Në pikën V të dispozitivit ka vendosur se ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anulura dhe ka karakter te detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar të prishet ashtu që të mbetet në fuqi vendimi Nr.5018 i datës 17.12.2018.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësja S.G, përmes përfaqësuesit të autorizuar, avokat Fitim Gashi nga Prishtina, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ankesën e përfaqësuesit të paditurit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.833/2019 i datës 30.05.2023, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, përgjigje në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin me nr. 5018 e dt.17.12.2018 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e z/znj. S.G, me numër të ID-së ... për njohjen e të drejtës në kompensim për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik për arsye se nuk janë plotësuar kushtet ligjore.

Paditësja e pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 05.04.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës vlerëson se pretendimet e paditëses janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se e njëjta i plotëson kushtet ligjore për të qenë përfitues i kompensimit financiar për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë. Gjykata e shkallës së parë, në të mirë të konstatimit të gjendjes faktike, me aktvendimin A.nr.833/19, të datës 01.11.2022, sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, e cila i është besuar Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës në Prishtinë, i cili me vendimin me numër protokollit 8208/3, të datës 18.11.2022, për kryerjen e kësaj ekspertize ka caktuar mjekë specialist, Dr. A.A-Neurolog, Dr. F.H - Fiziatër, dhe Dr. D.F - Urolog. Të njëjtët, më datë 08.12.2022, kanë përpiluar Raportin e ekspertizës, dhe gjykata e shkallës së parë po ashtu ka ftuar ekspertët mjekësorë të deklarohen lidhur me ekspertizën në seancën e shqyrtimit kryesor, me ç ‘rast ekspertja mjekësore A.H, me te cilën

kanë konstatuar se, pacientja në fjalë është person paraplegjik dhe tetraplegjik që do të thotë se hyn në grupin e parë dhe pacientes i takon edhe drejta për përcjellës/ kujdestar në mënyrë permanente. Gjykata e shkallës së parë për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, i'u referua Ligjit 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht neni 1, nenit 4. dhe Rregullores Nr.07/2017 Për Përbërjen, Funkcionin, Përgjegjësinë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenin 5 par.1 i saj janë përcaktuar Funkzioni dhe Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar secilën provë veç e veç, dhe të gjitha në lidhshmëri me njëra-tjetrën, dhe ka gjetur se kërkesëpadija e paditësve është e bazuar. Në veçanti, gjykata e shkallës së parë e ka krijuar bindjen e saj nga ekspertiza e nxjerrë nga grupi i ekspertëve pranë QKUK-së, të datës 08.12.2022, dhe deklaramit të ekspertëve në seancën e shqyrtimit kryesor, të cilët kanë konstatuar se, në bazë të ekzaminimit të drejtpërdrejt dhe shqyrtimit, të dokumentacionit mjekësor të shkresave të lëndës, vlerësojmë që pacientja S.G, vuan nga sëmundja Alzheimer – stadi i avancuar. Këto pasoja janë të shprehura në formë të paralizës së plotë të ekstremiteteve të sipërme dhe ekstremiteteve të poshtme, pamundësi e ecjes, pamundësi e kryerjes së nevojave fiziologjike dhe funksionimit të pavarur, i pamundur vertiklizimi. Janë të prekura të katër ekstremitetet (ekstremitetet e majta dhe e djathta plegji e plot dhe humbje e ndjeshmërisë totale, incontinece urinare). Këto pasoja janë të përhershme dhe meqenëse janë të prekura të katër ekstremitetet, e që nga kjo paditësja hyn në grupin e personave paraplegji dhe tetraplegjik dhe ka nevojë për rehabilitim të vazhdueshëm dhe përkujdesje nga personi tjetër – me diagnozën Incontinentio urinae. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar si provë edhe vlerësimin e Komisionit mjekësorë të së paditurës, të datës 26.11.2018, mirëpo duke qenë se i njëjti nuk përmban kurrfarë sqarime dhe arsytimi lidhur me gjendjen shëndetësore të paditëses dhe nëse e njëjta ka ndryshuar ose jo, ndërsa nga shkresat e tjera të lëndës vërtetohet se gjendja e saj nuk ka ndryshuar dhe këtë fakt e vërtetoi edhe ekspertiza mjekësore e nxjerrë në procedurë gjyqësore. Nga të gjitha këto arsye, gjykata e shkallës së parë nuk mundi t'i falë besimin vlerësimin dhe konstatimit të Komisionit Mjekësorë të së paditurës, si provë e vetme sipas së cilës paditësja nuk i plotëson kriteret e parapara me nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Prandaj, për faktin se paditësja ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura, gjykata e shkallës së parë kërkesëpadinë e saj e aprovoi si të bazuar dhe si rrjedhojë e detyron të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqë vlerësoi se sa i përket mendimeve dhe vlerësimit të ekspertëve, ekspertiza është e qartë, nuk ka kontradiktoritet në vete, si dhe e paditura nuk e ka kontestuar, nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, madje e paditura nuk i është përgjigjur as ftesave në seancën e shqyrtimit kryesor. Për të gjitha këto arsye, kjo gjykatë me qëllim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, respektivisht, në respektim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për një proces të rregullt brenda afateve të arsyeshme, nga vlerësimi i përgjithshëm ka krijuar bindje se ekspertiza e nxjerrë nga QKUK-së, është provë e besueshme e paanshme për të vendosur çështjen. Gjykata e shkallës së parë me qëllim që të përcaktohet vlera e saktë e kompensimit të kësaj të drejte e cila duhet të paguhet nga dita e kërkesës/ aplikimit së këtij pensioni, me kërkesën të autorizuarit të palës paditëse me Aktvendimin A.nr.833/19 të datës 22.02.2023, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare e cila i është besuar ekspertit financiar I.P. Me datën 17.03.2023, ka përpiluar Raportin e Ekspertizës Financiare dhe plotësimin të saj, të dorëzuar në gjykatë, dhe gjykata e shkallës së parë po ashtu ka ftuar ekspertin financiar të deklarohen lidhur me ekspertizën në seancën e shqyrtimit gjyqësor. Ndërsa, me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ është paraparë që “Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet”. Lidhur me përcaktimin e lartësisë së shumës në kompensimin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik përkatësisht pikës II të dispozitivit, gjykata e shkallës së parë i'u referua Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht neni 8 paragrafi 1. Me tej, lidhur

me realizimin e kompensimet të kësaj si në piken III të dispozitivit, gjykata e shkallës së parë ju është referuar nenit 9 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësinë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe nenit 17 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës, të dhëna në përgjigje, se paditësi nuk i ka plotësuar kriteret për njohjen e këtij pensioni, mirëpo, si të tilla, gjykata e shkallës së parë pasi i vlerësoi, i refuzoi si të pabazuara, pasi nuk i pa me ndikim në një vendimmarrje tjetër nga vërtetimi dhe vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka vendosur kur kërkesëpadinë e paditëses e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata bazohet në Ekspertizën e Ekspertëve mjekësor të QKUK-së, e cila ekspertizë është e mangët dhe e pa kuartë si dhe e pa argumentuar, ku nuk japin sqarime në paaftësinë e paditësve në asnjë pikë të ekspertizës, gjë që këto e bëjnë ekspertizën e mangët dhe të pa argumentuar. Pastaj se gjykata bazohet në mendimin e ekspertëve të QKUK-së e që është një grup prej tre anëtarëve, kurse nuk merr parasysh se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale nga Komisioni ekspert mjekësor nga shkalla e dytë ka vepruar në grup prej pesë ekspertëve mjekësor të lëmive përkatëse dhe kanë vlerësuar komplet dokumentacionin mjekësor si dhe raportet nga specialistet dhe është konstatuar se nuk kanë sjellë dëshmi të mjaftueshme mjekësore që dëshmon se ekziston pa aftësia e paditësve me paraplegjik dhe tetraplegjik në Grupin e parë. Po ashtu se ekspertët mund të vërtetojnë gjendjen faktike kur është bërë ekspertiza 2023, gjersa gjykata ja aprovon edhe kompenzimin në mënyrë retroaktive prej vitit 2018 ngase ekspertët e QKUK-së nuk e kanë vërtetuar se paditëja në vitin 2018 ka qenë person me aftësi tetraplegjik në grupin e parë, kjo është abstrakte dhe e pakuptimt dhe konsiderojmë se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, meqë nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ është vërtetuar se paditësja i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar, e në veçanti nga ekspertiza mjekësore e datës 08.12.2022 e mjekëve specialist të cilës gjykata e shkallës së parë me të drejtë ja fali besimin në tërësi, e cila është profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar, për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ. Pra gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të

vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate po ashtu nuk i aprovoi, për faktin se ekspertiza mjekësore është e qartë dhe nuk ka kontradiktë në vete, si dhe e paditura nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re. Andaj, të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.517/2023, me datë 14.02.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi